



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.15

Datë 2 mars 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9452 datë 2.2.2006	Për një ndryshim në ligjin nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”.....	501
Ligj nr.9470 datë 2.2.2006	Për një shtesë në ligjin nr.8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”.....	501
Vendim i GJK nr.4, datë 28.02.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.210, datë 5.11.2001 të Gjykatës Ushtarake të Shkallës së Parë Tiranë; nr.38, datë 2.06.2003 të Gjykatës Ushtarake të Apelit Tiranë dhe nr.496, datë 22.09.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	502

L I G J
Nr. 9452, datë 2.2.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8580, DATË 17.2.2000
“PËR PARTITË POLITIKE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Blerim Çela,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Në Buxhetin e Shtetit parashikohet ndihma financiare për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike.

70 për qind e ndihmës shtetërore ndahet sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti që merr pjesë në Kuvend, përfiton një mbështetje financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në mazhoritar dhe proporcional.

20 për qind e ndihmës shtetërore ndahet në mënyrë të barabartë midis partive parlamentare.

10 për qind e ndihmës shtetërore ndahet sipas përqindjes së fituar midis partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi, i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.”.

Neni 2

Ky lidh hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4786, datë 24.2.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 9470, datë 2.2.2006

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8527, DATË 23.9.1999 “PËR PRIVATIZIMIN E
HIDROCENTRALEVE VENDORE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 si më poshtë:

“Neni 3/1

KESH sha ka të drejtë të lidhë kontrata për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga këto hidrocentrale, sipas çmimit të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.”.

Neni 2

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 si më poshtë:

“Neni 5/1

Dispozita kalimtare

Për shlyerjen e detyrimeve kontraktuale të KESH sha-së për energjinë elektrike të marrë deri tani nga këto hidrocentrale, ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sha të përcaktojë kriteret e afatet e kryerjes së pagesave, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4789, datë 24.2.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

VENDIM

Nr. 4, datë 28.2.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 5.12.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.48/7 Akti, që i përket:

KËRKUES: AGIM HYSEN SHEHU, përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR:PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.210, datë 5.11.2001 të Gjykatës Ushtarake të Shkallës së Parë Tiranë; nr.38, datë 2.06.2003 të Gjykatës Ushtarake të Apelit Tiranë dhe nr.496, datë 22.09.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g dhe 129/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 28, 29, 30 dhe 45/1 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Me kërkesën e datës 14.09.2005 drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi ka paraqitur këto shkaqe për t'i deklaruar si antikushtetuese vendimet e mësipërme:

- Thirrja e të pandehurit nga organi i Prokurorisë, si dhe garantimi i mbrojtjes gjatë procesit të hetimit nuk janë bërë në përputhje me dispozitat respektive të Kodit të Procedurës Penale;

- Gjykata Ushtarake e Apelit Tiranë, me vendimin e rigjyimit nr.38, datë 2.06.2003, ka kapërcyer kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Përmes këtij vendimi është dënuar edhe për një veprë penale për të cilën, me vendim të mëparshëm të po kësaj gjykate, ishte pushuar çështja. Ky vendim ishte prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi rekursin e të gjykuarit;

- Gjykata Ushtarake e Apelit Tiranë, me vendimin nr.38, datë 2.06.2003, nuk ka zbatuar udhëzimet e lëna nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e saj nr.596, datë 30.10.2002;

- Rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë përmbante mjaft shkaqe ligjore, prandaj Kolegji Penal i kësaj gjykate, në dhomën e këshillimit, duhej të kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore;

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni i periudhës vijuese, nuk i konsiderojnë oficerët e policisë si subjekte ushtarake. Këto kanë sjellë ndryshime edhe në subjektet e përgjegjësisë penale ushtarake. Në këtë kuptim, në të gjitha vendimet është shkelur neni 29/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që garanton fuqinë prapavepruese të ligjit penal favorizues. Për pasojë, gjykimi i çështjes në shkallë të parë dhe të dytë, nuk është bërë nga një gjykatë kompetente;

- Largimi nga Shqipëria në qershor të vitit 1997, është bërë për shkak të frikës së bazuar se grupe të caktuara kriminale, kërcënonin seriozisht jetën e tij dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Pikërisht për këtë shkak, në bazë të Konventës së Gjenevës mbi “Statusin e refugjatit” të vitit 1951, ata kanë fituar statusin e refugjatit në Republikën Federale Gjermane. Nga viti 1992, në këtë Konventë është palë edhe vendi ynë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjorin, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.210, datë 5.10.2001 të Kolegjit Penal Ushtarak të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kërkuesi Agim Shehu, i gjykuar në mungesë, është deklaruar fajtor dhe është dënuar në bazë të nenit 34/2 të Kodit Penal Ushtarak me 7 vjet burgim për veprën penale të “Dezertimit të kuadrit komandues”, ndërsa lidhur me akuzën e “Shpërdorimit të armatimit...”, parashikuar nga neni 62/2 i këtij kodi, është vendosur pushimi i gjykitimit.

Mbi ankimin e të gjykuarit dhe të Prokurorit, Gjykata Ushtarake e Apelit Tiranë, me vendimin nr.38, datë 2.06.2003 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Ushtarake të Shkallës së Parë për dënimin e kërkuesit me 7 vjet burgim “Për dezertimin e kuadrit komandues, parashikuar nga neni 34/2 i Kodit Penal Ushtarak dhe ndryshimin e këtij vendimi në pjesën që ka pushuar çështjen për veprën penale të “shpërdorimit të armatimit të kryer në gjendje të jashtëzakonshme”, duke e deklaruar fajtor edhe për këtë veprë dhe dënuar atë në bazë të nenit 62/2 të Kodit Penal Ushtarak, me 5 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, Gjykata Ushtarake e Apelit Tiranë e ka dënuar përfundimisht kërkuesin me 8 vjet burgim. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.496, datë 22.09.2003 marrë në dhomën e këshillimit, bazuar në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Agim Shehu.

Në kërkesën e paraqitur Gjykatës Kushtetuese pretendohet se vendimet e mësipërme janë rezultat i proceseve të parregullta ligjore, prandaj ato duhet të shfuqizohen si antikushtetuese.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkuesit duhet të shqyrtohen në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor, trajtuar prej saj në zbatim të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore. Ajo rithekson se problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse, përmes këtij procesi, cenohen të drejtat kushtetuese themelore.¹

Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me verifikimin e kushtetutshmërisë së proceseve të zhvilluara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në thelb ato kanë të bëjnë me njëanshmërinë në gjykimin e çështjes, moszbatimin e detyrave të vëna nga Gjykata e Lartë, rëndimin e pozitës së kërkuesit, dënimin pa ligj, moszbatimin e ligjit penal favorizues. Shumica e këtyre pretendimeve janë parashtruar dhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, detyrë e së cilës është gjithashtu edhe kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon se, marrë në tërësi, në këtë rekurs janë ngritur probleme ligjore me rëndësi tepër të veçantë për shqyrtimin dhe fatin e çështjes, për të cilat është e nevojshme të mbajë qëndrim të shprehur Gjykata e Lartë. Bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe në parimin e subsidiaritetit që rezulton nga raportet që krijohen ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme², në rastin konkret, meqenëse kemi të bëjmë me të drejta kushtetuese themelore, vlerësohet si mëse e domosdoshme që Gjykata e Lartë të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit. Në këtë kuadër, veçanërisht i rëndësishëm është shqyrtimi i pretendimit për mosqenien subjekt i përgjegjësisë penale ushtarake, e aq më tepër të veprës penale ushtarake të dezertimit të kuadrit komandues, pretendimit për rëndimin e pozitës, pretendimit për shkelje të nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili garanton fuqinë prapavepruese të ligjit penal favorizues, si dhe të pretendimit të largimit nga Shqipëria në kushtet e frikës së bazuar të kërcënimit serioz të jetës së kërkuesit dhe anëtarëve të familjes së tij nga grupe të caktuara kriminale. Nga ky shqyrtim do të merrte përgjigje edhe pretendimi tjetër i kërkuesit për mosgjykimin e çështjes nga një gjykatë kompetente.

Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se vendimi nr.496, datë 22.09.2003 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.496, datë 22.09.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

¹ Shih vendimin nr.35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

² Shih vendimin nr.41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën:
Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"
- Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit:
04 255 563 ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të).....	1500
4. TAKSAT DHE TATIMET (suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT.....	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT.....	2000

DOLI NGA SHTYPI:

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 2.3.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2006

Çmimi: 50 lekë